PARLAMENTI STUDENTOR

Raporti i punës së Parlamentit Studentor të UUHP-së 2021-2022

15.10.2021

Kryetari i Parlamentit Studentor priti në takim përfaqësuesit nga organizata ORCA. Në këtë takim z.Fatlind Tredhaku së bashku me përfaqësuesit e ORCA, z.Dibran Hoxhaj dhe z.Gramos Buçinca, u zotuan se do të angazhohen së bashku për ngritjen e cilësisë në arsim, me theks të veçantë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren. Gjithashtu u dakorduan për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen, duke ofruar kështu projekte të ndryshme në të mirë të studentëve!

26.10.2021

Urealizua Panairi Virtual i Karrierës, i cili ka mirëpritur një numër të madh të institucioneve dhe kompanive të cilat kanë ofruar mundësi punësimi, punë praktike dhe karriere në fusha të ndryshme. Në kuadër të panairit studentët u informuan edhe për mundësitë e ndryshme për bursa, trajnime dhe seminare.

Panairi Virtual i Karrierës 2021 përfaqëson një burim të mundësive për zhvillimin e karrierës për qytetarët e Kosovës. Këtë vit, në përshtatje të situatës pandemike në vend, panairi u organizua në formë virtuale.

28.10.2021

Kryetari i Parlamentit Studentor Fatlind Tredhaku së bashku me Sekretaren e Parlamentit Studentor Fatjona Musliu dhe Senatorin Rinor Avdullahu zhvilluan një takim me përfaqësuesit e KFOR-it Britanez lidhur me gjendjen aktuale në Universitet.

Në këtë takim përfaqësuesit e KFOR-it u njoftuan rreth mbarëvajtjes së punës në Universitet.

Parlamenti Studentor ashtu sikurse përfaqësuesit e KFOR-it u dakorduan për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen, duke ofruar projekte të ndryshme për të mirën e studentëve dhe rinisë në përgjithësi!

22.11.2021

Këshilli Fakultetit të Shkencave Kompjuterike së bashku me Parlamentin Studentor ka organizuar vizitën studimore në Institutin "Inkos" ku u pritën nga Prof.Dr.Ass. Naim Baftiu

25.11.2021

Për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit, Parlamenti Studentor së bashku me Qendra për karrierë dhe alumni- Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren , zhvilluan Turnirin e Shahut, i cili tashmë do të organizohet tradicionalisht. Pjesëmarrës në këtë turnir përpos studentëve, ishin edhe profesorët dhe stafi nga Administrata e Universitetit. Fitues i turneut në fund u shpall studenti Labeat Berisha i cili ne finale mundi drejtorin e QKA z. Nehat Gashi.

26.11.2021

Në vazhdën e aktiviteteve për nder të 28 Nëntorit, Parlamenti Studentor organizoi orën letrare me përmbajtje artistike.
Të ftuar pos studentëve ishin edhe menaxhmenti i UUHP - së, i ftuar ishte edhe ish rektori i Universitetit të Bujqësisë së Tiranës Prof. Dr. Bahri Musabelliu, dekanët, prodekanët, stafi akademik dhe ai administrativ.
Kremtimi i festave të Nëntorit nuk është vetëm një përvjetor i thjeshtë, është kremtimi i të qenit tonë shqiptar.

27.11.2021

Vazhda e aktiviteteve për 28 Nëntor u përmbyll me vizitën e Parlamentit Studentor në Prekazin legjendar.

02.12.2021

Përfaqësuesit e Parlamentit Studentor dhe studentë të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, vizituan Qendrën e personave me Sindrom Down në Prizren (Down Syndrome Prizren), me ç'rast u pritën shumë ngrohtë nga ta.
Në këtë qendër u njoftuam nga afër me aktivitetet që zhvillohen aty dhe pamë që këtyre personave nuk u mungon talenti. Ata kishin përgaditur punime dore si kartolina, qirinjë dhe dekorime të ndryshme, të cilat shiten nga qendra si mënyrë e vetë financimit për t'i mbuluar shpenzimet e qendrës.

28.12.2021

Në kampusin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, studentët tanë së bashku me përfaqësuesit e Parlamentit Studentor zhvilluan aktivitetin e shitjes së kartolinave dhe qirinjve të punuar nga Qendra e Sindromës Down.

Aktivitetit tonë ju bashkangjit edhe Prorektorja për Mësim, Prof. ass. dr. Albana Plakiqi - Milaimi, e cila na përgëzoi për iniciativëm, dhe njëkohësisht shprehi gadishmëri të plotë që në të ardhmen të organizohen edhe shumë aktivitete të ngjashme humanitare.

Studentët e UUHP-së së bashku me stafin akademik dhe atë administrativ, kontribuan duke blerë punimet që janë punuar nga duart e arta të Qendrës Down Syndrome Prizren. Të hollat që u mblodhën në këtë aktivitet dedikohen për vetëfinancimin e Qendrës.

14.01.2022

Parlamenti Studentor i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren dhe organizata Alternativa Studentore-Prizren shpërndanë MIRËNJOHJE për përfaqësuesit e studentëve në të gjitha drejtimet e Fakulteteve për punën e palodhshme dhe kontributin e dhënë.

Ata ishin çdo herë të gatshëm për të dhënë ndihmë, ishin të pranishëm në çdo situatë dhe u munduan të bëjnë më të mirën për studentët që të gjitha kërkesat e tyre të adresoheshin në organet e universitetit. Mirënjohja është thjeshtë një copë letër e vogël por me vlerë dhe simbolikë të madhë. Kjo duhet të jetë shembull edhe motivim për studentët e tjerë të cilët do të jenë pasardhës në përfaqësim. Përmes këtij veprimi shprehet puna dhe ndihma e Parlamentit Studentor kundrejt studentëve.

Besojmë që kjo traditë e përfaqësimit të studentëve do të vazhdojë edhe në gjeneratat e tjera sepse mbi të gjitha studentët janë shtylla e universitetit.

02.02.2022

Udhëheqësi i QKA-së z. Gashi dhe Kryetari i Parlamentit Studentor z. Tredhaku vizituan Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë

Udhëheqësi i Qendrës së Karrierës dhe Alumnit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren z. Nehat GashI, sot së bashku me Kryetarin e Parlamentit Studentor z. Fatlind Tredhaku dhe kryetaret e këshillave studentore znj. Erva Kuksi dhe Samire Karavidaj vizituan Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë. Ata u pritën nga drejtori i kësaj qendre z. Abedin Selimaj, nga Nënkryetarja e Parlamentit Studentor znj. Albiona Kelmendi dhe Senatori i PS z. Vali Ahmetaj. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve dhe shkëmbimi i përvojave të qendrave të karrierës dhe alumnit dhe parlamenteve studentore dhe promovimi dhe avancimi i të drejtave të studentëve. Bashkërisht u dakorduam që takime të tilla të mbahen sa më shpesh.

15.02.2022

Në vazhdën e aktiviteteve, për nder të përvjetorit së pavarësisë së Republikës së Kosovës , Parlamenti Studentor së bashku me Këshillin Organizativ të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren organizuan një program me përmbajtje artistike dhe hapjen e ekspozitës "Kosova në arkivin e shtetit shqiptar".
Të ftuar pos studentëve ishin edhe menaxhmenti i universitetit, dekanët, prodekanët, stafi akademik dhe ai administrativ.
Kremtimi i festës së 17 Shkurtit nuk është vetëm një përvjetor i thjeshtë, është kremtimi i lirisë sonë që e pritëm me shekuj.

06.03.2022

Në vigjilje të Epopesë Çlirimtare të Kosovës, i përulemi përjetësisht dëshmorëve të kombit.
Studentet shprehen mirënjohje për më të shtrenjtit tanë, të cilët nuk kursyen as jetën që ne sot t'i gëzojmë këto ditë lirie.

07.03.2022

Pikërisht për të shënuar festën e 7 Marsit Parlamenti Studentor së bashku me Këshillin Studentor të Fakultetit të Edukimit, dhuruan një lule dhe një kimik me thënjen “Arsimi është shpirti i një kombi, ndërsa mësuesit janë shtylla e kombit” profesorëve universitar. Në kuadër të aktivitetit, studentët e bënë edhe një dhuratë si shenjë mirënjohje për Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren për ushtrimin me nder dhe përgjegjësi të misionit të shenjtë të mësimdhënies. Dhuratën e pranuan prorektorët dhe dekanët e universitetit.
Faleminderit për përkushtimin tuaj karshi nesh dhe urime 7 Marsin udhërrëfyesit tanë.

15.03.2022

Parlamenti Studentor së bashku me Koordinatorin e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit z. Nehat Gashi të Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren pritën në takim homologët nga Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë dhe Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë.
Qëllimi i takimit ishte vazhdimi i bashkëpunimeve ndërmjet universiteteve dhe shkëmbimi i përvojave të QKA-ve dhe Parlamenteve Studentore.
Bashkërisht u dakorduam që takime të tilla të mbahën më shpesh duke zhvilluar edhe aktivitete të përbashkëta për avancimin e të drejtave të studentëve.

21.03.2022

Studentët e Fakultetit Shkencave Kompjuterike vazhdojn aktivitetet e tyre me montimin dhe konfigurimin e sensorëve të tokës dhe të dritës "SMART CITY".

21.03.2022

Dita Ndërkombëtare e Pyjeve shënohet më 21 mars, si e tillë ajo është shpallur me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara miratuar më 28 nëntor të vitit 2012.
Çdo vit, ngjarje të ndryshme shënojnë këtë ditë duke ngritur dhe formësuar vetëdijen për rëndësinë e të gjitha llojeve të pyjeve, si dhe pemëve jashtë pyjeve, në dobi të brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.
Në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve vendet inkurajohen të ndërmarrin përpjekje për të organizuar aktivitete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që përfshijnë pyje dhe pemë, siç janë fushatat për mbjelljen e pemëve dhe aktivitete tjera!

23.03.2022

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është një ndër institucionet me të cilën në të ardhmen e afërm do të ketë bashkëpunim Universiteti "Ukshin Hoti"-Prizren. Më datë 15 Shkurt 2022 në oborrin e Universitetit është hapur ekspozita "Kosova në Arkivin e Shtetit Shqiptar" gjë që ishte nisma e bashkëpunimit. Kjo agjenci ruan, mbron dhe administron lëndën arkivore të organeve publike, të familjeve dhe subjekteve të tjerë, veprimtaria e të cilëve shtrihet apo është shtrirë në territorin e Kosovës që i referohet dokumentit të trashëguar nga e kaluara e Kosovës.

Pjesa më e mirë e tërë vizitës ishte edhe ekspozita me titullin “Bëje ose Vdis” për të madhin profesor Ukshin Hotin, që universiteti jonë gëzon ta ketë emrin e një njeriu të madh siç ishte profesor Ukshini. Shërbimi arkivor mund t`iu sigurojë gjeneratave të cilat vijnë të vërtetën për të kaluarën sepse askush nuk ka të drejtë të shkatërrojë kujtesën historike ose t'i zhdukë gjurmët e saj.

25.03.2022

Në Amfiteatrin e madh të universitetit u mbajt një program kushtuar "Demonstratave të Studentëve" të datës 11-26 Mars 1981. Ky program u realizua nga Parlamenti Studentor i Universitetit "Ukshin Hoti"- Prizren, i cili kishte për qëllim shfaqjen e idesë të realizimit të këtyre demonstratave. Bashkorganizatori i Demostratave të vitit 1981 ishte edhe tashmë Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit tonë Prof.Dr Kadri Kryeziu. Profesori Kryeziu përveq që është profesor si shembull për të tjerët ai është edhe një ndër iniciatorët të cilët i dhanë dritë të drejtave të studentëve.

25.03.2022

Në Amfiteatrin e madh të universitetit u mbajt një program kushtuar "Demonstratave të Studentëve" të datës 11-26 Mars 1981. Ky program u realizua nga Parlamenti Studentor i Universitetit "Ukshin Hoti"- Prizren, i cili kishte për qëllim shfaqjen e idesë të realizimit të këtyre demonstratave. Bashkorganizatori i Demostratave të vitit 1981 ishte edhe tashmë Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit tonë Prof.Dr Kadri Kryeziu. Profesori Kryeziu përveq që është profesor si shembull për të tjerët ai është edhe një ndër iniciatorët të cilët i dhanë dritë të drejtave të studentëve.

28.03.2022

Hulumtimi permes syzeve me temen “Dizajni dhe aplikimi i studenteve ne Web Faqet e Universiteve Publike” eshte aktiviteti qe ende eshte duke u zhvilluar ne laborator.

Qe ky hulumtim te jete sa me korrekt dhe i sakte, na u bashkangjiten edhe klubi i teknologjise i gjimnazit “Gjon Buzuku” ku e kane bere vlersimin e Web Faqes se Universitetit tone.

30.03.2022

Në vazhdën e aktiviteteve të Fakultetit Juridik në bashkëpunim me Këshillin Studentor dhe dekanin Prof. Asoc. Dr. Kadri Kryeziu, studentët realizuan vizita studimore në Parlamentin e Republikës së Kosovës, në Gjykatën Kushtetuese dhe në Pallatin e Drejtësisë. Studentët tanë u njoftuan nga afër rreth punës së këtyre institucioneve dhe po ashtu krijuan përvoja të reja.

01.04.2022

DITA BOTËRORE E NDËRGJEGJËSIMIT PËR AUTIZMIN

Në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, u shënua dita ndërkombëtare e vetëdijësimit të autizmit. Jo vetëm kjo ditë, jo vetëm kjo javë apo muaj, por i gjithë viti duhet të jetë ditë vetëdijësimi për shoqërinë tonë.

Kjo ditë shënimi u organizua nga bashkëpunimi i Këshillit Organizativ, Parlamentit Studentor dhe Këshillit të Fakultetit të Edukimit, njëherësh një falënderim për Prof. Asoc. Dr. Vedat Bajrami - Edukim Inkluziv, Prof. Ass. Dr. Pranvera Jetishi Çollaku - Psikologe dhe PhD Mulaim Kaçka - Logoped, të cilët ndanë përvojat e tyre profesionale me ne, po ashtu edhe ish studentja jonë Alberita Krasniqi e cila ndau përvojat e saja rreth trajtimit të autizmit në librin e saj.

07.04.2022

Ekipi i futsallit i Universitetit Ukshin Hoti fiton ndeshjen e parë të sezonit të ri në kuadër të Ligës Universitare të Kosovës. Në ndeshjen e parë ekipi i udhëhequr nga Udhëheqësi i Qendrës për karrierë dhe Alumni z. Nehat Gashi, mundën kampionët në fuqi, ekipin FEFS 2 me rezultat 2-1.

Universiteti Ukshin Hoti është i përkushtuar që të ofroj mbështetje edhe më të madhe për aktivitete jashtëkurrikulare në përgjithësi e për sportistët në veçanti.

15.04.2022

Studentët e Universitetit tonë të prirë nga kryetari i Parlamentit Studentor Fatlind Tredhaku, morën pjesë në Workshop-in e katërt drejt Kongresit të Aktivizimit Studentor në Kosovë ku u punua tema "Adresimi i korrupsionit në arsimin e lartë, përmes aktivizmit studentor dhe rrugëve ligjore"

20.04.2022

Këshilli Studentor i Fakultetit Ekonomik së bashku me stafin akademik të Fakultetit Ekonomik realizuan vizitë studimore në KOSHI GROUP LLC-Kompani e cila merret me dizajnin dhe prodhimin unik të detajeve të brendshme dhe të jashtme të veturave të cilat e kanë bërë KOSHI GROUP lider mbarëbotëror në tregun pasardhës për seritë italiane të makinave si Alfa Romeo dhe Abarth. Studentët tanë u njoftuan nga afër rreth punës dhe procesit të prodhimit të kësaj kompanie dhe po ashtu krijuan përvoja të reja duke marrë edhe këshilla të ndryshme për të ardhmen se si punohet dhe menaxhohet një kompani.
Falënderojmë stafin e Fakultetit Ekonomik dhe kompanin KOSHI Group për realizimin e kësaj vizite studimore.

23.04.2022

Dita Botërore e Librit

Parlamenti Studentor si pjesë e Rrjetit të Organizatave Rinore, mori pjesë në aktivitetin për të shënuar këtë ditë së bashku vetëm e vetëm që ta përqojmë një mesazh tek nxënësit, studentët dhe shoqëria që merr një libër dhe ndaje një tjetër me të tjerët. Aktiviteti filloj në Sheshin e Lidhjes ku morrëm nga një libër dhe marshuam drejt Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren vetëm e vetëm që ta pasurojmë bibliotekën lëvizëse që ndodhet në kampusin e universitetit.

13.05.2022

SEEU - aktivitieti i radhes i organizuar nga Keshilli i Fakultetit te Shkencave Kompjuterike. Ku studentat tane paten mundesi te shohin nga afer laboratoret punues, dhomat e VR, dhomat e droneve dhe qendrat e inkubimit.

17.06.2022

Në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, të premten është mbajtur ceremonia e shënimit të 79-vjetorit të lindjes së atdhetarit e ideologut, profesor Ukshin Hotit. Në ceremoni kanë marr pjesë, përpos strukturave udhëheqëse të universitetit, edhe shumë mysafir dhe familjarët e Ukshin Hotit.
Nikoqiri i këtij takimi, Rektori i Universitetit Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj, në fjalën e tij theksoi se është privilegj që është Rektor i një Universiteti që e ka emrin e Ukshin Hotit.
Në kuadër të aktiviteteve që shënuan 79 - vjetorin e lindjes së Ukshin Hotit, në Universitet është hapur edhe ekspozita me fotografi nga Arkivat Shtetërore të Kosovës, me titull “ Bëje ose vdis”, kushtuar ideologut Ukshin Hoti.

08.08.2022

Kryetari i Parlamentit Studentor Fatlind Tredhaku dhe Senatori Rinor Avdullahu u takuan me Parlamentin Studentor nga Agriculture University - Plovdiv, me Kryetarin Hristo Kozarov dhe Nënkryetarin Petar Antonov. Së bashku biseduam rreth përvojave që kemi si përfaqësues të studentëve në universitetet tona, drejtimet që kemi dhe mundësinë e bashkëpunimit që mund të kemi në të ardhmen si studentë. Dy parlamentet studentore ranë dakord që në të ardhmen e afërt të bëjnë vizita të ndërsjellta studentore me ç'rast të sjellin përvoja të reja tek universitetet e tyre.
Ky takim u mundësua falë Shkollës Verore Internacionale të Prizrenit që takoi studentët tanë dhe studentët e huaj duke bërë që ky dy javësh të jetë një përvojë e paharruar për ta.

22.09.2022

VAZHDIMI I AKTIVIZMIT STUDENTOR NË UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Sot, studentët e universitetit tonë pritën në takim përfaqësuesin e ORCA-s z. Dibran Hoxha duke vazhduar rrugëtimin e Kongresit Studentor edhe me universitetin tonë.

Në takim u diskutua strategjia fillestare e përgatitjes drejt Kongresit dhe përmirësimin e metodave të adresimit të problemeve studentore

23.09.2022

PËRMIRËSIMI I SHKATHTËSIVE TË KOMUNIKIMIT DHE VETË - PREZANTIMIT

Qendra e Karrierës dhe Alumnit e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren në bashkëpunim me GIZ-in dhe programin DIMAK mbajtën trajnimin me temën “Përmirësimi i shkathtësive të komunikimit dhe vetë - prezantimit”.
Qëllimi i këtij trajnimi është për të rritur aftësitë e vetë - prezantimit, sidomos prezantimeve të shkurta që janë shumë efikase duke
shfrytëzuara teknika të ndryshme.
Ky trajnim u mundësua në emër të qeverisë gjermane të implementuar nga GIZ Kosova.